



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.502/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesat e Ali Tafarshikut, Anëtar i kryesisë nga radhët e subjektit politik ALTERNATIVA, me seli në Gjakovë, paraqitur kundër Shend Binxhija, në cilësi të kryekomisionerit nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Gjakovë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të palejuara ankesat ZL.A.nr.502/2017, ZL.A.nr.503/2017 dhe ZL.A.nr.504/2017, të Ali Tafarshikut, Anëtar i kryesisë nga radhët e subjektit politik ALTERNATIVA, me seli në Gjakovë, të paraqitura me datën 24.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2017, PZAP-i ka pranuar tri ankesa nga Ali Tafarshiku i subjekti politik ALTERNATIVA, me seli në Gjakovë, me të cilat ankesa pretendohet se në vendvotimin 0202X21D, votuesi ka vërejtur se në Librin e nënshkrimeve, hapësira e tij ka qenë e nënshkruar nga dikush tjetër. Më tutje kryesuesi ka qenë nga subjekti politik AAK, prandaj rasti është paraqitur nga vëzhguesi Leon Shllaku i subjektit politik ALTERNATIVA dhe PZAP-it i ka kërkuar të rinumëroj vendvotimet. Për më tepër ka shtuar se në vendvotimin 0202X/04D Shefqet Dinaj në cilësinë e kryekomisionerit nga radhët e subjektit politik AAK, me marrëveshje me komisionerët tjerë, i njëjti ka lejuar mbushjen e fletvotimeve të mbetura, pasi që në këtë vendvotim subjekti politik ALTERNATIVA nuk ka pasur përfaqësues. Po ashtu në vendvotimin 0202C/06C kryesuesi i komisionerve nga subjekti politik AAK, Drilon Cena ka nxitur mënyrën e mbushjes së fletvotimeve të mbetura, duke i mundësuar secilit subjekt politik mbushjen e votave të mbetura. Prandaj nga të lartëcekurat PZAP-it i ka kërkuar rinumërimin e kutive të votimit.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesat janë të pa lejuara

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduara, në ankesa përkitazi me pa rregullsitë e votave, për shkak të pa rregullsive, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesave të ankuesit Ali Tafarshikut, Anëtar i kryesisë nga radhët e subjektit politik ALTERNATIVA, me seli në Gjakovë, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL. Anr.502/2017 më datën 25.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.